

# STATUT I SHOQERISE "LADY BRIDGE" SHPK

Në këtë Statut

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";

## Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

### Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, më 28/11/2022, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "LADY BRIDGE" SH.P.K.

(2) Themeluesit e shoqërisë janë:

1. Ortaku themelues **GANI SELMAN HOXHA**: Zoterues i 1 (Nje) kuote me vlerë të përgjithshme 10.000 leke që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

### Neni 2:

#### Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:


1. Investimi ne instrument financiar (te cilet perfshijne pa kufizime titujt e pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerive tregtare, titujt e borxhit, aksionet ose kuotat ne fonde investimesh etj), investime ne pasuri te paluajtshme dhe ne asetete (te prekshme apo te paprekshme), gjithashtu, shoqeria mund te kryej cdo veprim, operacion apo transakcion tjeter komercial, industrial e financiar, te dobishem apo plotesues ndaj permbushjes se objektit te shoqerise.  
Ne fushen e financimit te ndertimit e projektimit e projektimit te te gjitha llojeve te ndertesave, veprave industriale, turistike, rruge, etj.

Rikonstruksion dhe riparim i te gjitha llojeve te ndertimeve.

Shitja, blerja, marrja e dhenia me qira apo shfrytezimi i te gjitha llojeve te ndertesave e ndertimeve ne pergjithesi; Projektimi dhe zbatimi i punimeve te ndertimit si me poshte: ndertime me karakter ekonomik dhe civil, punime/germime dhe zhvendosje dheu, sitemim terrenesh, rikonstruksione te godinave me karakter ekonomik dhe civil, ndertim/rregullim fasadash, ndertime urash dhe konstruksionesh metalike, ndertime rruges, shtrim asfalti, germime si dhe cdo lloj punimi tjeter me karakter ekonomik dhe civil si ujesjellesa etj.

Tregetirni me shumice dhe pakice i cfaredolloj paisjeje qe perdoret per ndertim.

Ushtrimin e te drejtave te administrimit dhe shfrytezimit, rehabilitimit, modernizimit, financimit, te minierave, impianteve dhe uzinave/fabrikave;



Blerjen, shitjen, shkëmbimin dhe drejtimin e fabrikave, komplekseve industriale, eksplorimin e makinerive dhe impianteve, transportimin dhe tregtimin e burimeve natyrore dhe burimeve të energjisë elektrike dhe të materialeve energjitike dhe të derivative të tyre brenda kufizimeve të parashikuara nga ligji; Importin dhe eksportin e produkteve të rëndësishme që lidhen me prodhimin metalurgjik dhe të minierave; Qdo lloj aktiviteti tjetër që lidhet me pasurinë të luajtshme dhe të paluajtshme, veprime bankare dhe financiare të cfarëdo lloji dhe natyre, duke përfshirë krijimin e filialeve, degeve, agjensive dhe depozitave të mbajtura nga administratorët të nevojshme ose të dobishme për arritjen e objektivit të Shoqërisë, si dhe të marrë pjesë (në mënyrë direkte apo indirekte) në cfarëdo shoqëri tjetër të huaj me objekt të ngjashëm apo të lidhur me objektin e përmendur më sipër; Si dhe çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të Shoqërisë e që nuk bie nën ndesh me legjislacionin shqiptar në fuqi.

### Neni 3:

#### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë "Lady Bridge" Shpk fillon nga data e themelimit dhe do të jetë me një afat të pacaktuar.

### Neni 4:

#### Selia

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Diber Bashkia Klos, zyra nr.1, Shk 2, Pallati Kompleksi i Ri "Grapa Verde" Rr. Abdi Mati .

## Kreu II Kapitali

### Neni 5

#### Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **10.000 leke**

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **GANI HOXHA**: Zoterues i 1 (Një) kuote me vlerë të përgjithshme 10.000 leke që përben **100%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

**Ne total përbejnë 100% të kapitalit themeltar.**

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/te paluajtshme apo të drejta)

### Neni 6

#### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.





Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

### **Neni 7**

#### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie

### **KREU III**

#### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

### **Neni 8**

#### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.



Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## Neni 9

### Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsise.

## Neni 10

### Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## Neni 11

### Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;





f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;  
Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

#### Neni 12

##### Përfundimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.


2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

#### Neni 13

##### Administrimi

- (1) Asambleja e përgjithshme emëron si administrator të shoqërisë **znj. Natasha HOXHA** e datelindjes 15.04.1966 madhor e me zotesi të plotë për të vepruar, i identifikuar nga karta e identitetit me ID nr. **G65415247V**.
- (2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimeve të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.  
Cdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- (3) Personat e mëposhtem caktohen si administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Specimeni i nënshkrimit

Natasha Hoxha 

Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.

#### Neni 14

##### Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;



dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### **Neni 15**

##### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 16**

##### **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

#### **ORTAKU THEMELUES**

##### **E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**\* Lady Bridge\* SHPK**

